



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
DREJTORIA LIGJORE

Nr. ____ prot.

Tiranë, më _____.____.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Datë 06.09.2024

Drejtuar: Operatori ekonomik **QuantX IT Solutions** sh.p.k., me Nipt M31904013D
Me adresë: Rruga e Dibrës, Njësia administrative Nr.8, kati I Parë. Zona Kadastrale nr.
8370.1001 Nr. Pasurie 10/222/ND-N14 1001.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar”

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-13309-07-16-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje pajisje për menaxhim të qendëruar të infrastrukturës wireless në zyrat qendrore”, me fond limit 3,000,000 (tre milion) Lekë, pa TVSH.

Afati i dorëzimit të mallit është 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike datë 22.07.2024, nr. 40

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj, ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “**Advanced Business Solutions-ABS**” shpk, me Nipt K21710002J, me vlerë të ofertës 1,820,000 (një milion e tetëqind e njëzetë mijë lekë) pa tvsh.
2. Operatori ekonomik “**QuantX IT Solutions**” shpk, me Nipt M31904013D, me vlerë të ofertës 2,967,000 (dy milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë lek) pa tvsh.
3. Operatori ekonomik “**Sinteza CO**” me Nipt K11324003F nuk paraqitur ofertë ekonomike.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS” shpk, me Nipt K21710002J.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor dhe teknik të ofertës ekonomike, të paraqitur në tender rezulton që nuk i përmbushë plotësisht kriteret e përcaktuara për kualifikim:

Oferta e paraqitur në SPE është vlersuar anomalisht e ulët, oferta vlersohet anomalisht e ulët kur ka dy ose më pak oferta të vlefshme, si edhe është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

Referuar ligjit 16/2024 “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.162/2020 “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, është amenduar ligji 162/2020, ku një ndër ndryshimet kryesore është neni 27, ku shprehet: Neni 27, Në nenin 93 pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje: “5.Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetar, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët”.

Në sitem janë paraqitur dy oferta të vlefshme, dhe oferta e operatorit ABS është në vlerën 1,820,000 (një million e tetëqind e njëzetë mijë) lekë pa TVSH. Që të mos konsiderohej anomalisht e ulët duhet të ishte mbi vlerën 2,250,000 (dy milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

• Shtojca 8, “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”,

Dokumentacioni i paraqitur tek formulari përmbledhës i vetëdeklarimit nuk ka të njëjtin objekt me certifikimin e kërkuar.

▪ Pika 2.3.4 “Për kapacitetin teknik” e DST-së parashikon se:

-Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të ketë të punësuar specialistë të certifikuar të cilët plotësojnë kriteret në vijim:

Pika b) Të paktën 1(një) specialist të certifikuar CISSP, (Certified Information Systems Security Professional) ose ekuivalent.

Operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka staf teknik të kualifikuar për realizimin e kontratës 1(një) punonjës i certifikuar CISSP, (Certified Information Systems Security Professional) ose ekuivalent është garanci për Autoritetin Kontraktor që zhvillimi i testeve dhe vlerësimi i sigurisë së sistemeve të informacionit të realizohet në kohë me cilësi dhe sipas standarteve ndërkombëtare.

Ky certifikim garanton AK që OE ka në stafin e tij punonjës të certifikuar në fushën e sigurisë së informacionit të cilët zotërojnë njohuritë e nevojshme për të kuptuar gjithë aspektet e sigurisë së informacionit dhe aftësisë për ti zbatuar ato në praktikë.

Në dokumentat e paraqitura ekuivalentohen studimet në fushën e sigurisë kibernetike në një master professional me certifikim CISSP. Studimi në një fushë të caktuar nuk të bën automatikisht një person me njohuri specifike dhe të vërtetuara në një fushë të caktuar. Pra ndjekja e studimeve në fushën e sigurisë kirbenetike, nuk ekuivalenton njohuritë praktike që fitohen dhe certifikohen nga një certifikim i mirënjohur ndërkobëtarisht në fushën e sigurisë se informacioni sikurse është certifikimi i kërkuar në këtë rast CISSP, i cili konsiderohet një certifikim në nivelin SENIOR në fushën e sigurisë së informacionit. Në rast se do të

konsiderohet ekuivalente kjo do të duhet të bëhet nga një organizëm certifikues ndërkombëtar për programe të tilla studimi dhe certifikimi.

Të mbajturit një certifikim CISSP tregon një edukim në vazhdimësi dhe të thelluar të njohurive praktike në fushën e sigurisë së informacionit, duke validuar ekspertizën individuale dhe dedikimin në këtë fushë. Në fushën e sigurisë së informacionit diferenca midis CISSP dhe masterit të paraqitur është e tillë si midis një personi që ka luftuar dhe dikujt që ka parë duke luftuar.

2. Operatori ekonomik “**SINTEZA CO**” sh.p.k, Nipt **K11324003F** nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe asnjë dokument tekniko ligjor në SPE.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se Operatori ekonomik “**QuantX IT Solutions**” sh.p.k, me Nipt M31904013D me adresë: Rruga e Dibrës, Njësia administrative Nr.8, kati I Parë, Zona Kadastrale nr. 8370.1001, Nr. Pasurie 10/222/ND-N14 1001, se oferta e paraqitur, me një vlerë totale prej 2,967,000 (dy milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë lek) pa TVSH., është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë “Posta Shqiptare” SHA, Adresa: Rr., “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe do vijohet me hapat tjera të procedurës së prokurimit siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) - Nuk ka

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Ardit Demiri